

Nr. 189 prot.

Dt. 08.03.2021



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



1

Shoqata Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
DPPI

Shoqata Kombëtare e Grave Sipërmarrëse
Profesioniste dhe Zejtare
SHKGPZ

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE, në vijim referuar si "DPPI", përfaqësuar nga Znj. **Ledina Beqiraj**, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, që është një agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë. Veprimtaria e saj përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin nr. 9947 dt. 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

SHOQATËS KOMBËTARE TË GRAVE PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE, në vijim referuar si "SHKGPZ", përfaqësuar nga Znj. **Flutura Xhabija**, në cilësinë e Kryetares, që është shoqatë joftimprurëse, veprimtaria e së cilës, bazohet në Ligjin për OFJ, nr. 9180, datë 05.02.2004, i ndryshuar;

Duke synuar zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në lidhje me njohjen, përmirësimin e sistemit të mbrojtjes se Pronësisë Industriale në Shqipëri, shkëmbimin e informacionit, ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive të biznesit mbi të drejtat e Pronësisë Industriale, nëpërmjet trajnimeve, veprimtarive njohëse dhe promovuese dhe shërbimeve nga DPPI;

BIEN DAKORT:

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

NENI 1

Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve nënshkruese (më poshtë, "palët") lidhur me:

- Përmirësimin dhe pasurimin e përbajtjes së programeve të trajnimit me koncepte dhe analiza të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të sistemit të Pronësisë Industriale në Shqipëri.
- Planifikimin e organizimin e veprimit tarive të përbashkëta njohëse dhe promovuese për të mundësuar njohjen e kuptimin sa më të mirë IP nga biznesi.

2. Dy institucionet angazhohen të punojnë së bashku në përputhje me kërkesat ligjore dhe fryshtat e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje.

NENI 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- Të përcaktojnë projekte bashkëpunuese në interes për të dyja palët
- Organizime të aktiviteteve të përbashkëta brenda vendit, sesione bisedimesh (ëorkshops)
- Të ndajnë njohuritë e të dhënët që avancojnë interesin reciprok të palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e se cilës palë.
- Të mbajnë komunikim efektiv ndërmjet tyre për të realizuar projekte apo trajnime me interes për të dyja Palët.
- Të identifikojnë nevojat që ka shoqata dhe të jepin konsulencë në lidhje me pronësinë industriale.
- Përcaktimi konkret dhe rishikimi i rregullt i drejtimeve të bashkëpunimit;
- Informimi në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme i palës tjetër për përbushjen e angazhimeve në këtë marrëveshje si dhe për zhvillimet në se cilin institucion, që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër;
- Shkëmbimi i materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore të lidhura me aktivitetin e DPPi dhe SHKGPAZ në respekt të parimit të konfidencialitetit dhe mirëbesimit;
- SHKGPAZ do të krijojë hapësira organizative për vënien në dispozicion të përfaqësueseve

Shoqata Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare

të SHGPAZ, materiale të ndryshme burimore, dokumente e të dhëna për treguesit ekonomikë duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe politikave të aksesit të të dhënave të IP.

- j. DPPI, do të mundësojë krijimin e hapësirave institucionale për zhvillimin e trajnimeve në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe planifikimit/njoftimit paraprak.
- k. Ide dhe bashkëpunime të tjera do t'i shtohen këtij memorandumi kur të lindë e nevojshme, me miratimin e të dy palëve.

NENI 3 Pronësia industriale

Kur si rezultat i bashkëveprimeve të kryera në përputhje me këtë Marrëveshje, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbi pronësinë industriale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 4 Komunikimi

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm. Me qëllim, përbushjen e objektivave të kësaj marrëveshje, secila palë do të caktojë një person si koordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.

NENI 5 Kufizimet e marrëveshjes

1. Të dy palët bien dakort që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me fryshtën e kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë të bien dakort mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do ti rregullojnë këto raporte me marrëveshje të veçanta financiare të cilat do të janë pjesë integrale e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
5. Palët bien dakort që të ruajnë dhe respektojnë integritetin reciprok.

NENI 6

Ndryshimi, amendimi dhe revokimi i Marrëveshjes

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

NENI 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

NENI 8

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të palëve, dhe do t'i shtrijë efektet për një periudhë kohe të pakufizuar.

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje dhe secila palë mban një kopje në origjinal.

Nënshkruar sot, më datë ___ / ___ /2021, në Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësise Industriale
DPPI

Ledina Beqirai
Drejtore i Përgjithshëm

Shoqata Kombëtare e Grave Sipërmarrëse
Profesioniste dhe Zejtare
SHKGPAZ

Flutura Xhabija
Kryetare

